

Rexhep Ismajli: STUDIMET PËR SHQIPTARËT NË BRITANI DHE NË VENDET E EVROPËS VERIORE

fjalë e hapjes e Konferencës, ASHAK, 26 tetor 2023

Kolege dhe Kolegë të nderuar,

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) bashkë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë janë organizuese të konferencës shkencore me temën “*Studimet për shqiptarët në Britani dhe në vendet e Evropës Veriore*”.

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në dy raste dhe në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ka mbajtur deri tash katër konferenca shkencore ndërkombëtare në të cilat janë vështruar zhvillimet e studimeve albanistike, më 2015 “*Studimet albanistike në Amerikë*”; më 2017 “*Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*”, më 2019 “*Studimet albanistike në Itali*”, më 2021 “*Studimet dhe shkrimet për shqiptarët në Francë*”. Për të gjitha këto konferenca pati interesim dhe pjesëmarrje të gjerë.

Në vijim të kësaj përvoje u vendos të organizohet kjo konferencë për “*Studimet për shqiptarët në Britani dhe në vendet e Evropës Veriore*”. Dua të përsëris edhe me këtë rast atë që kisha thënë me rastin e konferencës për studimet në botën gjermanishtfolëse, këto konferenca organizohen dhe në përgjigje të nevojave për komunikim sa më të hapur midis studiuesve të mjediseve të ndryshme, duke mirëpritur vrojtimit e të gjitha llojeve, sidomos të diskutimeve dhe të problematizimeve. Në këtë kuptim është synuar dhe mirëpritur pjesëmarrja sa më e madhe e kolegëve nga vendet për zhvillimet e të cilave flitet.

Në raport me konferencat e mëparme të këtij lloji ka rënë në sy se në të fundit, për Francën, ashtu si në këtë të tashmen, fokusi i interesimit është zgjeruar, nuk bëhet më fjalë vetëm për studimet albanistike, po edhe për shqiptarët në përgjithësi, në një anë, dhe jo më vetëm për studimet, po edhe për shkrimet përkatëse. Ky zgjerim i intersit ndërlidhet me dy aspekte që na mësoi përvoja e mëparme: e para ka të bëjë me faktin se studimet albanistike e ngushtonin ndjeshëm horizontin e interesimeve për botën shqiptare, çka edhe mund të justifikohet për rastet e botës gjermanishtfolëse, apo edhe të Italisë, ndërsa në rastet e botës tjetër duket qartë se ato interesime për botën shqiptare kanë qenë dukshëm të ndërlidhura dhe se

dilte jo shumë e përshtatshme të fokusoheshim vetëm tek albanistika dhe të liheshin anash aspekte me rëndësi themelore pak përtej kësaj lidhur me botën shqiptare, e që reflektoheshin dhe në studimet albanistike. E dyta ka të bëjë me faktin se në këto hapësira shumë shpesh interesimet shkencore dhe profesionale për botën shqiptare kanë qenë të ndërlidhura me botime të veçanta, siç janë udhëpërshkrimet.

Interesi i autorëve britanikë për botën shqiptare shtyhet në kohë deri nga fillimi i shekullit XVIII, kur historiani Edward Gibbon për Shqipërinë fliste si për "*një tokë brenda harkut të Italisë, por më pak e njohur se brendësia e Amerikës*". Më duket i drejtë vlerësimi i Noel Malcolm, sipas të cilit '*Deri në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kontaktet midis Britanisë dhe Shqipërisë ishin minimale, shumë pak në nivelin personal dhe aspak në nivelin zyrtar*'. Rebelët..., 2020, f. 327. Ky lloj interesimi i britanikëve për shqiptarët dhe Shqipërinë ka zgjuar interesin e studiuesve shqiptarë qysh herët. Mithat Frashëri (Lumo Skëndo), vetëm tash vonë i nxjerrë nga hija për arsye politike, në serinë e shkrimeve për *Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të sh. të XIX-të*, të botuara kryesisht te *Diturija* në vitet 1927-29, i kishte komentuar gjerësisht shënimet e më të famshmit prej udhëtarëve të tillë, të poetit markant të romantizmit, Lordit Byron. Sipas Skëndos ai '*ka bërë mbase më të madhen e bujavet – sado që nga pikëpamja shkencore s'pati nonjë fryt si eksplorim dhe zbulime për Shqipërinë*'. Pasi kishte paraqitur për lexuesit edhe shënimet e J. C. Hobhouse-it, të H. Holland-it, pastaj të J.J. Best-it, të D. Urquhart-it, të Doduell-it, etj. Lumo Skëndo përnga pesha e çmonte sidomos veprën e Edward Lear-it: *Journals of a landscapes painter in Albania*, 1851, si vepër të piktorit që shpërfaqte pejzazhet e bukura para opinionit britanik dhe tjetër, duke nxitur kështu kureshtjen për vendin.

Kjo gjerësi vështrimesh lidhur me botën shqiptare në opinionin shkencor e kulturor britanik ka qenë e ndërlidhur me shumë aspekte të zhvillimeve historike në Europën e atëherëshme, sidomos me aspektet e interesimit të Europës Perëndimore - Francë, Britani, Itali në raport me Perandorinë Osmane. Kështu që përshtypjet e Lordit Byron, apo ato të Lear-it zgjuan kureshtjen e shumë njerëzve të tjerë. Në po atë kohë në Ballkan dhe ndër shqiptarë kanë udhëtuar dhe kanë lënë dokumente të shkruara të rëndësishme edhe William Martin Leake, Lordi John Hobhouse, etj.

Në shekullin XX, gjithnjë e cilësuar si udhëtare në viset shqiptare, njihet Edith Durham, e cila, duke kuptuar thelbin e rendit fisnor shoqëror e juridik të zonave malsore veriore, sillte të dhëna me peshë për njohjen shkencore të tipareve, zakoneve dhe dokeve të shqiptarëve në Ballkan. Atë e kishte magjepsur pikërisht organizimi shoqëror, jeta shoqërore-fisnore malësore. Po në gjysmën e parë të shekullit XX, Stuart E. Mann shkroi tekste me rëndësi për gjuhën shqipe nga aspekti i gjuhësisë krahasimtare dhe i historisë së gjuhës, botoi një gramatikë, fjalorin historik, trajtesa historike-antologjike për letërsinë, fjalorin shqip-anglisht, gramatikën historike të shqipes, etj. Në një shënim të vitit 1969 ai linte përshtypjet përfundimtare sumariuese: "*Me shkelë në Shqipëri dyzet vjet më parë ishte si me shkelë në një botë tjetër... Çka ishte e çuditshme për mua, i diplomuar në Bristol, ishte ta gjeja veten në një botë muslimane në Europë... Shqipëria sot nuk është i njëjti vend si dyzet vjet më parë... Atje tash ka një universitet të mirë me katër fakultete. Feja është ndaluar dhe e tërë ekonomia është mbledhur te marksizmi stalinist. Kënetat janë tharë dhe malaria tashmë është bërë çështje e së kaluarës...*" Megjithatë, kishte refuzuar të shkonte.

Në tri dekadat e fundit ka pasur një interes të shtuar të britanikëve për botën shqiptare dhe kjo ndërlidhet drejtpërsëdrejti dhe me Kosovën. Në këtë aspekt u botuan libra dhe shkri-me për çështje të ndryshme, disa të lidhura drejtpërsëdrejti me zhvillimet në terren gjatë viteve '90. Ndhimesa e historianit Noel Malcolm, interesimet e të cilit ndërlidhen me studimet e tij për raportet midis Venedikut dhe Perandorisë Osmane, erdhën duke u zgjeruar në hapësirat ballkanike, fillimisht me Bosnjën, pastaj me aspekte të ndryshme me historinë shqiptare, sidomos me historinë e tij të Kosovës, vepër që e solli në qendër të interesimeve. Vrojtimet e tij ndërlidheshin dhe me vëzhgimet e zhvillimeve të drejtpërdrejta politike-shoqërore në Kosovë, po edhe në Bosnje dhe në tërë Ballkanin. Pati dhe një varg interesimesh pikërisht për aspektet çlirimtare të Kosovës dhe të shqiptarëve në këto turbullira.

Sot në Britaninë e Madhe ka një gjallërim të interesit për studimet shqiptare, si në fushat e historisë ashtu edhe në fushat e filologjisë, përfshirë në kohët tona edhe interesin për kulturën dhe letërsinë. Nuk ka dyshim se gjallërimi i diasporës shqiptare atje luan një rol. Në përgjithësi, autorët britanikë tash e tre shekuj, megjithë largësinë gjeografike, kanë dhënë një ndihmesë me vlerë për njohjen e botës shqiptare.

Interesimet për shqiptarët, për gjuhën, kulturën dhe historinë e tyre, nuk kanë munguar

as tek autorët që vijnë nga vendet skandinave dhe nga Evropa Veriore në përgjithësi. Në këto hapësira ka pasur më shumë interes për gjuhën shqipe në kuadër të studimeve krahasuese indoeuropiane, e më vonë edhe për shqipen e sotme, në radhë të parë për studimet gjuhësore. Janë të njohura qysh në fillimet e tyre interesimet e studiuesve Rasmus Rask e Sophus Bugge për historinë e krahasuar dhe për etimologjitë indoeuropiane. Në fushat e studimit të historisë së gjuhës shqipe shquhen ato të indoeuropeistit të madh Holger Pedersen. Janë shquar po ashtu studimet e romanistit e ballkanologut Kristian Sandfeld për raportet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit, pak më vonë të sllavistit e rumanistit Gunnar Svane në fushën e filologjisë e të shqipes së autorëve të vjetër, po edhe të raporteve të shqipes me gjuhët sllave, etj. Në ato hapësira ka pasur dhe interesa për studimin e aspekteve të tjera të kulturës, të letrave e me këtë edhe të miqësive me shqiptarët në sh. XX. Është shquar në këtë drejtim depërtimi në studimin e raporteve të realitetit shoqëror shqiptar i studiueses dhe mikes së madhe shqiptare me fat tragjik të antropologes norvegjeze Berit Becker në fund të sh. 20. Sot në ato vende vepron diaspora kulturalisht e gjallë nga Kosova e Shqipëria. Interesimet për gjuhën dhe botën shqiptare kanë qenë të rëndësishme edhe në Holandë dhe vendet e tjera të Europës Veriore, sidomos ndër ballkanologë, sllavistë e romanistë dhe tash vonë ndër historianë, studiues të kulturës e të religjionit dhe gjuhëtarë që janë marrë me Ballkanin.

Në kohët tona ka gjithnjë e më shumë interes për intensifikimin e këtyre kontakteve të botës intelektuale shqiptare gjithandej (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, diasporë) me zhvillimet studimore në Britaninë e Madhe dhe në Europën Veriore në përgjithësi.

Uroj të kemi dy ditë të ngjeshura pune me kumtesa dhe diskutime të gjalla.